



GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Buletini Informativ

Janar — Qershor 2018



PËRMBAJTJA:

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS	2
VIZITAT DHE AKTIVITETET E GJYKATËS.....	5
PËRVOJAT DHE PRAKTIKAT PERSONALE.....	11
GJEDNJ - VENDIME TË RËNDËSISHME	13
AKTGJYKIME.....	17

Kushtetuta e Kosovës - Kapitulli VIII

Gjykata Kushtetuese

Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësi të saj.

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [*Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.






Statusi i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmujore: 1 janar – 30 qershor 2018, Gjykata ka pasur në punë gjithsej 182 kërkesa/lëndë.

Gjithsej 91 kërkesa janë zgjidhur ose 50% e të gjitha rasteve në disponim.

Gjatë kësaj periudhe, 95 vendime dhe 2 mendime mospajtuese janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës.

*Dinamika e kërkesave të pranura sipas muajve
(1 janar – 30 qershor 2018)*



Në vijim janë paraqitur 9 aktgjykimet që Gjykata nxori gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 janar – 30 qershor 2018:

- Aktgjykim në rastin KI 122/16, parashtruar nga: Riza Dembogaj. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit CML. nr. 6/2016 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 13 shtatorit 2016.
- Aktgjykim në rastin KI 115/16, parashtruar nga: Branko Ljumovic, Ranko Ljumovic dhe Anica Vukicevic-Ljumovic. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II-12-0126, të 21 prillit 2016.
- Aktgjykim në rastin KI 62/17, parashtruar nga: Emine Simnica. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PN. II. nr. 1/17, të 30 janarit 2017, në lidhje me aktvendimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 300/16, të 12 dhjetorit 2016.

- Aktgjykim në rastin KI 69/16, parashtruar nga: Nora Dukagjini-Saliu. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 295/2015, të 9 dhjetorit 2015.
- Aktgjykim në rastin KO 12/18, parashtruar nga: Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017.
- Aktgjykim në rastet nr. KI 146/17, KI 147/17, KI 148/17, KI 149/17 dhe KI 150/17, parashtruar nga: Isni Thaçi, Zeqir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, dhe Jahir Demaku. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. KZZ. nr. 322/2016, të 19 korrikut 2017.
- Aktgjykim në rastin KO 45/18, parashtruar nga: Glauk Konjufca dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.
- Aktgjykim në rastin KI 122/17, parashtruar nga: Ceska Exportni Banka A.S. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit Ae. nr. 185/2017 të Gjykatës së Apelit, të 11 gushtit 2017, dhe aktvendimit IV. EK. C. nr. 273/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 14 qershorit 2017.
- Aktgjykim në rastin KI 97/16, parashtruar nga: "IKK Classic". Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. 15/2016, të 16 marsit 2016.

Llojet e shkeljeve të pretenduara


Llojet e shkeljeve të pretenduara nga 89 kërkesat e pranura gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 janar – 30 qershor 2018, janë si në vijim:

- Neni 21 [Parimet e përgjithshme], 2 raste ose 2,2%;
- Neni 24 [Barazia para ligjit], 5 raste ose 5,6 %;
- Neni 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë], 1 rast ose 1.1%;
- Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të



- paanshëm], 43 raste ose 48.4%;
- Neni 32 [E drejta për mjete juridike], 1 rast ose 1.1%;
- Neni 36 [E drejta e privatësisë], 1 rast ose 1.1%;
- Neni 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes], 1 rast ose 1.1%;
- Neni 46 [Mbrojtja e pronës], 20 raste ose 22.5%;
- Neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], 3 raste ose 3.4%;
- Neni 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut], 1 rast ose 1.1%;
- Neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave], 2 raste ose 2.2%;
- Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë], 1 rast ose 1.1%;
- Neni 102 [Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor], 2 raste ose 2.2%;
- Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të institucioneve shtetërore, 1 rast ose 1.1% dhe
- Shkelje të tjera, 5 raste ose 5.6%;

Shkeljet e pretenduara, sipas llojit të shkeljeve (1 janar – 30 qershor 2018)




Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 79 ose 88,8 % të kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave

- 9 ose 10,1 % të kërkesave kanë të bëjnë me autoritetet e tjera publike
- 1 ose 1,1 % e kërkesave kanë të bëjnë me interpretime (sqarime) kushtetuese

Shkelësit e supozuar të të drejtave (1 janar – 30 qershor 2018)




Qasja në Gjykatë

Qasja e individëve në Gjykatë është si në vijim:

- 47 kërkesa nga shqiptarët, ose 52,8%;
- 9 kërkesa nga komuniteti serb, ose 10,1%;
- 1 kërkesa nga komuniteti boshnjak, ose 1,1%;
- 11 kërkesa të nacionaliteteve të tjera, ose 12,4%;
- 21 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet e tjera publike (personat juridik), ose 23,6%;

Struktura etnike e paraqitësve të kërkesave (1 janar – 30 qershor 2018)



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 janar – 30 qershor 2018, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 24 seanca plenare dhe 83 kolegje shqyrtuese, në të cilat, rastet e shqyrtuara u zgjidhën me vendime, me aktvendime




dhe me aktgjykime. Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithsej 95 vendime.

Struktura e vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 9 Aktgjykime (9,5%)
- 78 Aktvendime për papranueshmëri (82,1%)
- 6 Vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër (6,3%)
- 1 Vendim për hedhje poshtë të kërkesës (1,1 %)
- 1 Heqje e kërkesës nga lista (1,1%)

*Struktura e vendimeve
(1 janar – 30 qershor 2018)*



16 janar 2018



Gjykata Kushtetuese në bashkëpunim me Programin e USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë (JSSP), shënoi me një ceremoni solemne lansimin e ueb-faqes së re të Gjykatës, e cila u mbajt në “Sheshin 21” në Prishtinë. Me një fjalim rasti, pjesëmarrësve në këtë ceremoni iu drejtuan kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, si dhe drejtori i Misionit të USAID-it në Kosovë, z. James Hope.

Në fjalimin e saj kushtuar lansimit të ueb-faqes së re të Gjykatës, kryetarja Rama-Hajrizi ndër të tjera tha: *“Dizajnimi i ueb-faqes së re është konceptuar duke marrë për shembull karakteristikat dhe cilësitë e ueb-faqeve më moderne të institucioneve të drejtësisë në botë, ku në veçanti vlen përmendur mundësinë e re për kërkimin më të avancuar të vendimeve të Gjykatës. Besoj që tash e tutje, ueb-faqja e re do të përafrojë edhe më shumë publikun e gjerë dhe mediet me vendimet dhe me punën e Gjykatës Kushtetuese”.*

Me ndihmën e ueb-faqes së re, e cila përfaqëson një përpjekje serioze të Gjykatës për rritjen e nivelit të transparencës, si dhe të komunikimit më të mirë dhe më cilësor me publikun, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, e në veçanti përfaqësuesit e sistemit gjyqësor, juristët dhe pjesëtarët e tjerë të komunitetit juridik, tash e tutje do të kenë mundësi shumë më praktike për kërkim dhe hulumtim të avancuar të vendimeve të Gjykatës. Kërkimin e avancuar e mundëson baza e të dhënave të vendimeve në ueb-faqe, e cila pjesërisht është projektuar sipas shembullit të ueb-faqes së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me seli në Strasburg. Mundësia e kërkimit të avancuar është projektuar edhe në seksionet e tjera të ueb-faqes, krahas mundësisë së abonimit të drejtpërdrejt në buletinet e praktikës ligjore, buletinet informativ, si dhe në vendimet e fundit të publikuara nga Gjykata. Zhvillimi i ueb-faqes është financuar në tërësi nga Programi për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë të USAID-it, që është njëri prej donatorëve dhe partnerëve më të rëndësishëm të Gjykatës Kushtetuese që nga themelimi i saj.

Prezantimi i ueb-faqes së re të Gjykatës Kushtetuese u bë nga drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim dhe njëherësh kryesuesi i Grupit punues për zhvillimin e ueb-faqes, z. Veton Dula, si dhe këshilltari ligjor i Gjykatës dhe njëri nga anëtarët e Grupit punues për zhvillimin e ueb-faqes, z. Jeton Bytyqi.

2 shkurt 2018



Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Milot Vokshi, priti në takim Sekretarin e Përgjithshëm të sapoemëruar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, z. Eugen Papandile. Në takimin e përbashkët, dy sekretarët diskutuan çështje me rëndësi përkitazi me veçoritë dhe dallimet në organizimin e punëve në administratën e të dy gjykatave kushtetuese, sfidat me të cilat aktualisht përballen këto institucione, si dhe përpjekjet për reforma të mëtutjeshme me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe të transparencës në punë.

Pasi i vlerësuan si shumë të mira marrëdhëniet bilaterale ndërinstitucionale, sekretari Vokshi dhe homologu i tij, Papandile, shprehën gatishmërinë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit reciprok nëpërmjet shkëmbimit të përvojave, organizimit të vizitave studimore dhe punëtorive të përbashkëta, në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe përvetësimit të standardeve bashkëkohore të administrimit nga të dy gjykatat.

Sekretari Papandile, i cili në vizitë shoqërohej edhe nga këshilltari ligjor në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, z. Ermal Tauzi, zhvilloi takime të ndara edhe me drejtorët e departamenteve të ndryshme të administratës dhe me këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

7 mars 2018

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i përbërë nga zëvendëskryetari i Gjykatës, Ivan Čukalović, gjyqtari Altay Suroy dhe këshilltari i parë juridik i Gjykatës, Sevdail Kastrati, qëndroi për



vizitë zyrtare në Ankara. Vizita e delegacionit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u realizua me ftesë të Gjykatës së Kasacionit të Turqisë, për të marrë pjesë në kremtimin e 150-vjetorit të themelimit të kësaj gjykate. Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara me rastin e shënimit të përvjetorit jubilar të themelimit të Gjykatës së Kasacionit të Turqisë, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës mori pjesë edhe në Simpoziumin ndërkombëtarë të organizuar në temën: “Roli i Gjykatës së Kasacionit në sistemin gjyqësor të Turqisë”. Gjatë qëndrimit në Ankara, zëvendëskryetari Čukalović dhe gjyqtari Suroy u pritën në takim të veçantë nga kryetari i Gjykatës së Kasacionit të Turqisë, z. İsmail Rüşti Cirit.

9 mars 2018



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, e shoqëruar nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, z. Almiro Rodrigues dhe znj. Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës, z. Milot Vokshi, qëndroi për vizitë zyrtare në Zagreb.

Në kuadër të vizitës së realizuar me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, kryetarja Rama-Hajrizi dhe delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës zhvilluan takime të ndara me homologët e tyre kroatë. Gjatë bashkëbisedimit me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, z. Miroslav Sheparović, kryetarja Rama-Hajrizi vuri theksin në progresin dhe të arriturat që janë shënuar deri më tash në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës, si dhe në respektimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimmarrje. Kryetarja Rama-Hajrizi më tutje nënvizoi rëndësinë dhe

domosdoshmërinë e përkrahjes së Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë në përpjekjet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për anëtarësim në organizatat dhe në forumet e ndryshme ndërkombëtare të gjykatave kushtetuese.

Të dy kryetarët në vazhdim shkëmbyen pikëpamjet e tyre përkitazi me sfidat me të cilat vazhdojnë të përballen gjykatat kushtetuese të të dyja vendeve, si dhe për nevojën e forcimit të pavarësisë së sistemit gjyqësor, në funksion të sundimit më efikas të ligjit.

Gjatë qëndrimit në Zagreb, kryetarja Arta Rama-Hajrizi dhe delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u pritën në takim edhe nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kroacisë, z. Goran Jandroković.

16 mars 2018



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim njohës ambasadorën e re të Finlandës në Kosovë, znj. Pia Stjernvall.

Në takim, ndërmjet tjerash, u diskutua për punën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese, për efikasitetin e rritur në trajtimin e lëndëve, për transparencën e shtuar në punë, si dhe për rëndësinë e konsolidimit të mëturjeshëm të gjyqësisë kushtetuese në vend.

Kryetarja Rama-Hajrizi në vazhdim vuri theksin në marrëdhëniet shumë të mira të bashkëpunimit reciprok me gjykatat homologe në rajon dhe më gjerë, si dhe në përpjekjet që po bëhen për unifikimin e praktikës gjyqësore në funksion të harmonizimit me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ajo shprehu falënderimin e saj për kontributin e vazhdueshëm që Finlanda i ka ofruar institucioneve në vend, e në veçanti Gjykatës Kushtetuese, me ç'rast shprehu bindjen se marrëdhëniet e mira ndërmjet dy shteteve do t'i ndihmojnë vendin tonë për të tejkaluar më lehtë sfidat që paraqiten në kuadër të proceseve integruese evropiane.

Ambasadorja Stjernvall rikonfirmoi vazhdimin e mbështetjes së Qeverisë finlandeze për institucionet e Kosovës, duke e vlerësuar si parësor progresin e mëtejshëm në sundimin e të drejtës dhe në respektimin e të drejtave të njeriut në vend.

20 mars 2018



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi dhe gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka-Nimani, morën pjesë në diskutimin e mbajtur në temën: *“Sfidat dhe mundësitë në sundimin e ligjit”*, që u organizua në Prishtinë nga Misioni i USAID-it në Kosovë. Sistemi gjyqësor i Kosovës, situata aktuale dhe rruga përpara, mundësitë dhe sfidat e përfshirjes së femrave në gjyqësor, ishin ndër temat kryesore që u trajtuan në këtë takim.

Kryetarja Rama-Hajrizi dhe gjyqtarja Caka-Nimani prezantuan para pjesëmarrësve në diskutim, në mesin e të cilëve ishin edhe ndihmës-zëvendës administratorja e USAID-it për Evropë dhe Azi, znj. Gretchen Birkle, dhe drejtori i Misionit të USAID-it në Kosovë, z. James Hope, pikëpamjet e tyre përkitazi me sfidat kryesore në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës, si dhe për mundësitë e përfshirjes më aktive të femrave në sistemin gjyqësor në vend.

Pas diskutimit të mbajtur, kryetarja Rama-Hajrizi zhvilloi një takim të veçantë me znj. Birkle, me të cilën, pasi që e falënderoi për ndihmën e deritanishme që USAID-i i ka ofruar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, diskutoi më gjerësisht për punën e deritanishme të këtij institucioni, sfidat aktuale në përtëritjen e përbërjes së gjyqtarëve, si dhe për mundësitë e realizimit të projekteve të përbashkëta në mbështetje të ngritjes së kapaciteteve profesionale të Gjykatës.

20 mars 2018

Një grup studentësh të Fakultetit Juridik të Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë, vizitoi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Studentët u pritën në takim nga këshilltari i parë juridik i Gjykatës Kushtetuese, z. Sevdail Kastrati, dhe këshilltarja e re juridike, znj. Anita Çavdarbasha.

Në takim, këshilltari Kastrati i njohu studentët me mënyrën e funksionimit dhe me kompetencat e Gjykatës Kushtetuese në kuadër të sistemit shtetëror të Kosovës, me mënyrën e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës dhe me procesin e vendimmarrjes.

Një sqarim më të hollësishëm ai i bëri edhe zbatimit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në sistemin kushtetues të Kosovës, si dhe palëve të autorizuara për parashtrimin e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese. Ndërkaq, këshilltarja Çavdarbasha njoftoi studentët me fazat e procedimit dhe të shqyrtimit të kërkesave të parashtruara, duke ofruar njëherësh informata të përgjithshme statistikore përkitazi me numrin e kërkesave të shqyrtuara dhe përkatësinë etnike të parashtruesve. Studentët shprehën interesimin e tyre që të informohen edhe për raportin e Gjykatës Kushtetuese me gjykatat e niveleve të tjera në vend, për kriteret e pranueshmërisë së kërkesave, si dhe për afatet kohore për shqyrtimin e tyre.



10 prill 2018

Me ftesë të Kolegjit “AAB” dhe të Institutit për studime kushtetuese dhe parlamentare “ISKP”, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, mori pjesë në tryezën me temë *“10 vjet Kushtetutë”*, e cila u mbajt në Prishtinë. Në tryezën e organizuar në kolegjin “AAB”, me rastin e 10-vjetorit të miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kryetarja Rama-Hajrizi mbajti një prezantim në temën: *“Përvoja e Gjykatës Kushtetuese – Rrugëtimi drejt suksesit”*. Gjatë prezantimit të saj,



kryetarja Rama-Hajrizi foli ndër të tjera për rëndësinë e hartimit të Kushtetutës së re të Kosovës, rrethanat në të cilat ajo u miratua, si dhe për mundësitë që ajo i krijoi për themelimin e institucioneve të reja, përfshirë këtu edhe Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Kryetarja Rama-Hajrizi në vazhdim diskutoi edhe për punën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese, sfidat që ajo i ka tejkualuar pas themelimit, duke veçuar njëherësh edhe disa prej vendimeve të saj më me rëndësi.

Në përmbyllje të fjalës, ajo shprehu zotimin se Gjykata Kushtetuese dhe gjyqtarët e saj do të vazhdojnë me devotshmëri punën e tyre në mbrojtje të Kushtetutës dhe të kushtetutshmërisë në vend.

10 prill 2018



Një grup nxënësish të përzgjedhur nga shkollat fillore në qytete të ndryshme të Republikës së Kosovës, vizituan Gjykatën Kushtetuese. Nxënësit u mirëpritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Arta Rama-Hajrizi, e cila fillimisht u bëri një prezantim të shkurtër mbi historikun e hartimit të Kushtetutës së re të Republikës së Kosovës dhe rëndësinë që ka ky dokument për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirisë themelore të njeriut në vend.

Kryetarja Rama-Hajrizi në vazhdim i njoftoi nxënësit edhe me funksionin që ka dhe me punën që bën Gjykata Kushtetuese, me përbërjen e saj dhe me mënyrën e zgjedhjes së gjyqtarëve, si dhe me rolin aktiv që ka kjo Gjykatë në mbrojtjen e kushtetutshmërisë në vend. Në përmbyllje të takimit, kryetarja Rama-Hajrizi u dhuroi nxënësve edhe nga një kopje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me urimin që duke e ruajtur dhe duke e respektuar atë, të gjithë së bashku të ndërtojmë një të ardhme edhe më të mirë për vendin tonë.

Vizita e nxënësve u realizua nën organizimin e përbashkët të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të Programit për Transformim të Liderimit (TLP) të Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), me rastin e shënimit të 10-vjetorit të miratimit të Kushtetutës së Kosovës.

11 prill 2018




Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, mori pjesë në

ceremoninë e shënimit të 10-vjetorit të miratimit të Kushtetutës së Kosovës, që u organizua nga Ministria e Drejtësisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të martën, më 10 prill 2018, në Prishtinë. Ajo iu drejtua pjesëmarrësve në këtë ceremoni me një fjalim rasti.

26 prill 2018

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Turqisë, një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i përbërë nga gjyqtari Altay Suroy dhe gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, udhëtoi për në Ankara.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës mori pjesë në ceremoninë e kremtimit të përvjetorit të 56-të të themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, si dhe në konferencën ndërkombëtare të organizuar me



këtë rast, me temë: “*Vlerësimi i pesë viteve të para të ankesave individuale*”, që u mbajt në kryeqytetin turk, më 25 dhe 26 prill 2018. Gjatë qëndrimit në Ankara, krahas pjesëmarrjes në përvjetorin e themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, gjyqtarët Suroy dhe Caka-Nimani u takuan edhe me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, z. Zühtü Arslan, dhe me zëvendëskryetarin e kësaj gjykate, z. Burhan Üstün. Marrëdhëniet ndërmjet dy gjykatave kushtetuese, si dhe mundësitë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit reciprok, ishin ndër temat që u diskutuan në takimin e përbashkët.

3 maj 2018

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës e vizituan studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë. Studentët u pritën në takim nga këshilltari i parë juridik i Gjykatës Kushtetuese, z. Sevdail Kastrati, dhe këshilltarja juridike, znj. Arbana Beqiri-Plakolli.

Funksioni dhe roli që ka Gjykata në bazë të Kushtetutës, organizimi i saj i brendshëm, mënyra e trajtimit të rasteve, përbërja dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarëve, si dhe raporti me gjykatat e niveleve të tjera në vend, ishin vetëm disa prej temave për të cilat këshilltari Kastrati diskutoi me studentët e Universitetit të Mitrovicës.

Përkritazi me palët e autorizuara për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, fazat e procedimit të kërkesave të parashtruara, strukturën etnike të parashtruesve

dhe zbatimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjatë shqyrtimit të rasteve, studentët i informoi më hollësisht këshilltarja Beqiri-Plakolli.

Gjatë bashkëbisedimit, studentët shprehën interesimin e tyre edhe për të drejtën e Gjykatës Kushtetuese në vetë-inicimin e rasteve, për të drejtën e palëve në angazhimin e avokatëve mbrojtës, për afatet dhe kohëzgjatjen e shqyrtimit të lëndëve, si dhe për kriteret e parashikuara për pranueshmëri të kërkesave.

10 maj 2018



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, z. Per Strand Sjaastad.

Puna e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese, si dhe sfidat me të cilat aktualisht përballet ky institucion, ishin disa prej çështjeve për të cilat kryetarja Rama-Hajrizi e njoftoi ambasadorin Sjaastad. Temë e bashkëbisedimit ishin edhe çështja e avancimit të legjislacionit vendor në mbrojtje të të drejtave të njeriut, zbatimi efektiv i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe përfundimi i mandatit të disa prej gjyqtarëve të Gjykatës dhe domosdoshmëria e përzgjedhjes së gjyqtarëve të rinj. Kryetarja Rama-Hajrizi e falënderoi ambasadorin Sjaastad për ndihmën që shteti norvegjez i ka ofruar deri më sot Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe për realizimin e projekteve të ndryshme në lëmin e gjyqësisë kushtetuese. Ambasadori Sjaastad u zotua për mbështetjen e mëtutjeshme të punës së pavarur të Gjykatës Kushtetuese nga qeveria e vendit që përfaqëson.

6 qershor 2018

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në

në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë së Republikës së Kosovës organizuan punëtorinë e përbashkët në temën: *“Roli dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Raporti me gjykatat e rregullta dhe institucionet tjera”*, e cila u mbajt në gjykatoren e Gjykatës Kushtetuese. Qëllimi i punëtorisë së mbajtur ishte informimi i prokurorëve të sapoemëruar të Republikës së Kosovës, me rolin dhe me kompetencat që ka Gjykata Kushtetuese në raport me gjyqësorin e rregullt, si dhe me institucionet e tjera në vend, për të cilat ata u njoftuan më për së afërmi nga këshilltari i parë juridik i Gjykatës, z. Sevdail Kastrati. Këshilltari Kastrati i njoftoi prokurorët e rinj edhe me pranimin dhe me procedimin e kërkesave të parashtruara nga palët, me kriteret e pranueshmërisë së kërkesave, si dhe me ankesat individuale ndaj vendimeve të gjykatave të rregullta, e në veçanti të Gjykatës Supreme të Kosovës. Prokurorët e rinj ndërkaq shprehën interesimin e tyre për t'u informuar më hollësisht përkitazi me shqyrtimin që i bën Gjykata Kushtetuese ankesave për stërzgjatje të procedurave gjyqësore nga gjykatat e rregullta, afatet kohore për shqyrtimin e kërkesave, si dhe për procesin e shqyrtimit të rasteve në bazë të radhës së parashtrimit/regjistrimit të tyre. Përkitazi me marrëdhënien e bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të Komisionit të Venecias, prokurorët e rinj i njoftoi më në detaje Drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim, z. Veton Dula, njëherësh Zyrtar ndërlidhës i Gjykatës Kushtetuese me Komisionin e Venecias.



13 qershor 2018

Me rastin e përfundimit të mandatit të katër gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese: të zëvendëskryetarit Ivan Çukaloviq, të gjyqtarit Altay Suroy dhe të gjyqtarëve ndërkombëtarë Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova, në Prishtinë, të u mbajt ceremonia lamtumirëse e organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Në fjalimin e rastit të mbajtur në praninë e përfaqësuesve më të lartë institucional, të gjyqësorit dhe të përfaqësuesve ndërkombëtar në vend, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Arta Rama-Hajrizi, shprehu mirënjohjen dhe falënderimin e saj për kontributin e jashtëzakonshëm që gjyqtarët Rodrigues, Botusharova, Çukaloviq dhe Suroy, kanë dhënë për vendosjen e themeleve të gjyqësisë kushtetuese në Republikën e Kosovës. *“Me përfundimin e përnjëhershëm të mandatit të katër gjyqtarëve të*

grupit të parë të emëruar pas themelimit, Gjykata Kushtetuese dhe gjyqësia kushtetuese e Kosovës në përgjithësi, po humbin katër gjyqtarë dhe ekspertë të jashtëzakonshëm të fushës. Zëvendësimi i gjyqtarëve me kësi kualitete profesionale dhe me përvojë kaq të gjatë në lëmin e së drejtës kushtetuese, nuk ka dyshim se do të jetë një proces mjaft sfidues dhe i vështirë për të gjithë ne”, ka thënë, ndër të tjera, kryetarja Rama-Hajrizi në fjalimin e mbajtur.



Për kontributin e dhënë në themelimin dhe në avancimin profesional të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese, z. Almiro Rodrigues dhe znj. Snezhana Botusharova, janë dekoruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, me Medaljen Presidenciale Jubilare të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë, në një ceremoni solemne të zhvilluar në Zyrën e Presidentit, më 8 qershor 2018. Me Medaljen Presidenciale Jubilare të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë, Presidenti Thaçi dekoroi edhe ish-gjyqtarin ndërkombëtar të Gjykatës Kushtetuese, z. Robert Carolan, i cili ishte anëtar i Gjykatës deri në shtator të vitit 2016.





Anita G. Krasniqi

Programi i praktikës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Strasburg

Ishte nder dhe privilegj i imi që ta ndjek programin e vizitës studimore në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mes të 1 gushtit dhe 31 dhjetorit 2016, si pjesë e grupit të gjashtë të zyrtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Ishte një përvojë që shumica e juristëve dhe avokatëve nga fusha e të drejtave të njeriut e synojnë dhe e ëndërrojnë në aspektin e zhvillimit të tyre profesional dhe ngritje të karrierës.

Pasi u regjistrova si praktikante në GJEDNJ, që nga dita e parë jam caktuar që të punoj në Sekretariatit e Gjykatës nën mbikëqyrjen e Stefano Piedimonte, udhëheqës i Departamentit për kërkime dhe znj. Genevieve Woods, udhëheqëse e bibliotekës. Përveç detyrave të tjera të cilat më ishin caktuar gjatë trajnimit tim, aktivitetet e mia të përditshme përfshinin detyrat e mëposhtme:

- skanimin e të gjitha materialeve në Përmbledhjen e Dosjes së Bibliotekës
- eliminimi i numrave të pasaktë të thirrjeve 'H' nga baza e të dhënave të Bibliotekës Simfonia
- Shtimi i informatave të përmbajtjes së librave në regjistrin e bazës së të dhënave të Bibliotekës Simfonia
- Shqyrtimi i punës së Departamentit për kërkime dhe bibliotekë.

Përveç rutinës sime të përditshme, kam pasur mundësinë të marr pjesë në disa nga kurset dhe seminarët hyrëse shumë interesante të Gjykatës, duke

përfshirë seancën e trajnimit mbi bazën e të drejtave të praktikës gjyqësore të HUDOC dhe mbi menaxhimin e rasteve dhe metodave të punës. Për më tepër, pata rastin të punoja një ditë në Zyrën Qendrore dhe Arkivat e Gjykatës dhe të kisha një pasqyrë më të afërt lidhur me procedurat dhe metodat e punës të këtij departamenti shumë të rëndësishëm të Gjykatës.

Mësimet e nxjerra

Marrja e njohurive të përgjithshme për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe njohja me aktivitetet e përditshme dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me sistemin e menaxhimit të lëndëve dhe përdorimin e bazës së të dhënave, ishin përvoja të vlefshme të këtij trajnimit.

Trajnimi gjithashtu ka pasur një ndikim shumë pozitiv në aftësitë e mia personale të punës rutinore dhe të menaxhimit, të cilat janë ndryshuar dhe përmirësuar dukshëm pas kthimit tim në Kosovë.

Përveç kësaj, duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me kolegët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ne tanimë i kemi ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të përmirësuar metodat e përpunimit të rasteve të Gjykatës. Dhe ky është vetëm fillimi i ndryshimeve dhe përmirësimeve të rëndësishme që ne kemi për qëllim t'i zbatojmë në punën tonë të përditshme, duke pasur gjithmonë parasysh përvojat dhe praktikën më të mira të GJEDNJ-së.

Në këtë drejtim, do të doja të shfrytëzoj këtë mundësi dhe të shpreh mirënjohjen time personale ndaj z. Stefano Piedimonte, udhëheqës i Departamentit për kërkime dhe znj. Genevieve Woods, udhëheqëse e bibliotekës së GJEDNJ-së, të cilët më kanë përkrahur në çdo fazë të programit të trajnimit tim në Strasburg.

Dëshiroj gjithashtu të falënderoj ish-Kryetarin dhe Kryetaren e tanishme të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe Qeverinë Zvicerane, mbështetja bujare e të cilëve e bëri të mundur që unë të ndjek programin e trajnimit në GJEDNJ.



Veton Dula

Programi i praktikës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Strasburg

Kam pasur kënaqësinë dhe privilegjin të jem pjesë e programit të vizitës studimore në Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut nga 1 gushti deri më 31 dhjetor 2016, një projekt i vlefshëm i organizuar me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe financuar nga Qeveria Zvicerane. Si edhe kolegët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të cilët kanë kaluar këtë program trajnimi para meje, kam pasur rastin e rrallë të jem dëshmitar dhe të përjetoj në radhë të parë praktikën më të mira të punës së një institucioni që përfaqëson kujdestarin e fundit dhe kryesor të të drejtave të njeriut jo vetëm në Evropë.

Duke qenë i caktuar në Njësinë për Medie të GJEDNJ-së, që nga dita e parë jam përfshirë në hartimin e përmbledhjeve për disa njoftime për shtyp të Gjykatës dhe përmbledhjen e vendimeve të Gjykatës. Unë gjithashtu jam caktuar në përgatitjen e pasqyrës së brendshme të shtypit, e cila u kushtohet vetëm gjyqtarëve dhe anëtarëve të Sekretariatit të Gjykatës, duke iu referuar burimeve të lajmeve nga mediet në mbarë botën. Kam pasur gjithashtu rastin që të dëshmoj dhe të marr pjesë në disa seanca të profilit të lartë në Dhomën e Madhe të Gjykatës, gjatë të cilave isha dëshmitar i procesit të akreditimit të medieve dhe pjesëmarrjes së publikut në këto seanca. Faqja e internetit dhe intraneti i Gjykatës ishin një tjetër platformë interesante për të bashkëveprim, duke përfshirë motorin e avancuar të kërkimit të praktikës gjyqësore "Hudoc". Gjatë praktikës sime në Gjykatë, kam pasur gjithashtu një bashkëpunim të

vazhdueshëm me ekipin e Njësisë së internetit dhe kam marrë pjesë rregullisht në takimet javore të Njësisë për Medie.

Mësimet e nxjerra

Përveç njohjes me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe marrjes së njohurive të përgjithshme lidhur me aktivitetet e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, vizita studimore më dha mundësinë e veçantë për të zgjeruar njohuritë e mia të përgjithshme përkitazi me mediet dhe marrëdhëniet me publikun. Krahas përgatitjes së njoftimeve për shtyp dhe përmbledhjes së vendimeve (shpesh komplekse) të Gjykatës, ishte një përvojë shumë interesante të shihej edhe një qasje tjetër e komunikimit me publikun, si dhe përdorimi i mjeteve të reja të komunikimit, të cilat unë me siguri synoj t'i vë në praktikë në punën time të përditshme në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Faqja e internetit e GJEDNJ-së është diçka që unë besoj se çdo gjykatë ose institucion gjyqësor në botë duhet t'i referohet si një shembull i mjetit të komunikimit praktik në internet, i transparencës dhe informatave të dobishme. Pres me padurim që t'i aplikoj disa nga tiparet themelore të kësaj faqeje në faqen e internetit të re dhe të ri-dizajnuar të Gjykatës sonë në Kosovë. Pjesëmarrja në takimet javore me anëtarët e tjerë të Njësisë së Shtypit të GJEDNJ-së ishte një tjetër përvojë e çmuar, në kuptimin e një pune ekipore të vërtetë dhe të sinqertë dhe të praktikave më të mira të menaxhimit. Në këtë drejtim, do të doja të falënderoj veçanërisht për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm, z. Patrick Titium, Shef i Njësisë për Media dhe Zyrës Private të Kryetarit të GJEDNJ, si dhe znj. Tracey Turner Tretz, zyrtare e lartë për shtyp, që më bëri të ndihem si anëtar i vërtetë i Njësisë për Medie dhe pa të cilët do të ishte i pakuptimtë trajnimi im në GJEDNJ. Dëshiroj po ashtu të shpreh vlerësimin tim për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre në aktivitetet e mia të përditshme për anëtarët e tjerë të Njësisë për Medie: znj. Sylvie Ruffenach, znj. Lavinia Bucurenciu, znj. Tzvetomira Popova, znj. Inci Ertikin, z. Denis Lambert dhe z. George Stafford.

Gjithashtu, dëshiroj të falënderoj ish-Kryetarin dhe Kryetaren e tanishme të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Qeverinë Zvicerane dhe Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, përpjekjet dhe mbështetja bujare e të cilëve e bëri të mundur që unë dhe kolegët e tjerë në Kosovë të jemi pjesë e programit të vizitës studimore në GJEDNJ.



GJEDNJ – Vendime të rëndësishme (1 janar – 30 qershor 2018)

* Aktgjykimi në lidhje me kërkesën e gazetarit Mehmet Hasan Altan, i cili u arrestua dhe u ndalua pas përpjekjes së grusht shtetit ushtarak (20/03/2018)

Pas shqyrtimeve të mbajtura më 20 shkurt 2018 mbi pranueshmërinë dhe meritat e rastit së Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë (kërkesa nr. 13237/17), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut në aktgjykimin e saj konstatoi: - me shumicë votash (gjashtë vota ndaj një), **se ka pasur shkelje të nenit 5 paragrafi 1 (E drejta për liri dhe siguri)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; - me shumicë (gjashtë vota ndaj një), konstatoi se ka pasur **shkelje të nenit 10 (Liria e shprehjes)**; dhe - njëzëri, se **nuk ka pasur shkelje të nenit 5 paragrafi 4 (e drejta për shqyrtim të shpejtë të ligjshmërisë së paraburgimit)** për shkak të mungesës së pretenduar të një shqyrtimi të shpejtë gjyqësor nga Gjykata Kushtetuese.

Sipas nenit 5 paragrafi 1, Gjykata konstatoi në veçanti se vazhdimi i paraburgimit të z. Altan, pas aktgjykimit të qartë dhe të kuptueshëm të Gjykatës Kushtetuese të 11 janarit 2018, që kishte gjetur shkelje të nenit 19 paragrafi 3 të Kushtetutës, nuk mund të konsiderohej si “i ligjshëm” dhe “në pajtim me procedurën e paraparë me ligj” siç kërkohet me të drejtën për liri dhe siguri. Në lidhje me këtë, Gjykata vërejti në veçanti, se arsyet e dhëna Gjykata e Shkallës së Parë 26 të Stambollit në hedhjen poshtë të kërkesës për lirimin e z. Altan, pas një vendimi “përfundimtar” dhe “të detyrueshëm” të nxjerrë nga autoriteti i lartë gjyqësor kushtetues, nuk mund të konsiderohet si plotësim i kërkesave të nenit 5 paragrafi 1 të Konventës. Gjykata konsideroi që kur një gjykatë tjetër vë në pikëpyetje kompetencat që i janë dhënë një gjykate kushtetuese për të nxjerrë aktgjykime përfundimtare dhe të detyrueshme për kërkesat individuale ishte në kundërshtim me parimet themelore të sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike, të cilat ishin të qenësishme në mbrojtjen e ofruar me nenin 5 të Konventës dhe ishin gur themeli i garancive kundër arbitraritetit. Gjykata theksoi se vazhdimi i paraburgimit të z. Altan, pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, ngriti dyshime serioze në lidhje me efektivitetin e zgjidhjes së një kërkesë individuale në Gjykatën Kushtetuese në rastet në lidhje me paraburgim. Sidoqoftë, siç qëndronte çështja, Gjykata nuk kishte ndërmend të largohej nga konstatimi i saj i mëparshëm (Koçintar, § 442) se e drejta për të parashtruar kërkesë individuale në Gjykatën Kushtetuese përbënte një mjet efektiv në lidhje me ankesat e personave të privuar nga liria e tyre. Megjithatë, ajo rezervoi të drejtën për të shqyrtuar efektivitetin e sistemit të kërkesave individuale në Gjykatën Kushtetuese në rastet e ngritura sipas nenit 5 të Konventës, sidomos duke pasur parasysh zhvillimet e mëvonshme në praktikën gjyqësore të gjykatave të

të shkallës së parë, sidomos në lidhje me autoritetin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Sipas nenit 10, Gjykata veçanërisht konstatoi se nuk kishte asnjë arsye për të nxjerrë një përfundim tjetër nga ai i Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte konstatuar se paraburgimi fillestar dhe i vazhdueshëm i z. Altan, pas shprehjes së mendimeve të tij, përbënte masë të ashpër që nuk mund të konsiderohej si ndërhyrje e nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike. Në këtë drejtim, Gjykata theksoi në veçanti se kritikën ndaj qeverive dhe publikimi i informatave që konsiderohen nga udhëheqësit e një vendi si rrezikim i interesave kombëtare nuk duhet të tërheqin akuza penale për vepra veçanërisht të rënda siç janë përkatësia ose ndihma e një organizate terroriste, duke u përpjekur të përmbysë qeverinë ose rendin kushtetues ose shpërndarjen e propagandës terroriste.

Sa i përket ankesës në bazë të nenit 5 paragrafi 4 lidhur me kohëzgjatjen e procedurës në Gjykatën Kushtetuese (14 muaj dhe tri ditë), Gjykata konstatoi se situata në këtë rast ishte e jashtëzakonshme, veçanërisht për shkak të kompleksitetit të rastit dhe numrit të tanishëm të rasteve të Gjykatës Kushtetuese. Në fund, Gjykata refuzoi njëzëri ankesën lidhur me ligjshmërinë e ndalimit policor të parashtruesit të kërkesës (neni 5 paragrafi 3) për mosshterimin e mjeteve juridike të brendshme, si dhe ankesat lidhur me mungesën e qasjes në shkresat hetimore (neni 5 paragrafi 4) dhe e drejta për kompensim për ndalim të paligjshëm (neni 5 paragrafi 5) si qartazi të pabazuar.

* GJEDNJ miraton vendimet e gjykatave gjermane për të marrë fëmijët e Kishës së Dymbëdhjetë Fiseve në përkujdesje për shkak të ndëshkimit fizik (22/03/2018)

Në aktgjykimet e saj në rastet **Tlapak dhe të tjerët kundër Gjermanisë** (nr. 11308/16 dhe 11344/16) dhe **Wetjen dhe të tjerët kundër Gjermanisë** (kërkesat nr. 68125/14 dhe 72204/14), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut njëzëri konstatoi se nuk kishte pasur: **shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rastet kishin të bënin me tërheqjen e pjesshme të autoritetit prindëror dhe marrjen në kujdes të fëmijëve që i përkasin Kishës së Dymbëdhjetë Fiseve (Zwölf Stämme), që jetojnë në dy komunitete në Bavari (Gjermani). Në vitin 2012, shtypi raportoi se anëtarët e kishës i ndëshkonin fëmijët e tyre fizikisht. Raportet u vërtetuan më pas nga pamjet e ndëshkimeve të filmuara me një kamerë të fshehtë në një nga komunitetet. Në bazë të këtyre raporteve të shtypit, si dhe deklaratave të ish-anëtarëve të kishës, fëmijët që jetonin në komunitete u morën në përkujdesje në shtator të vitit 2013 me urdhër të gjykatës. Procedura në Gjykatën Evropiane është iniciuar nga katër familje që janë anëtare të Kishës së Dymbëdhjetë Fiseve. Ato ankohen se gjykatat gjermane kishin tërhequr pjesërisht autoritetin e tyre prindëror dhe kishin ndarë



familjet e tyre. Gjykata u pajtua me gjykatat gjermane se rreziku i dënimit sistematik dhe të rregullt të fëmijëve me rrahje justifikonte tërheqjen e një pjese të autoritetit prindëror dhe marrjen e fëmijëve në përkujdesje.

Vendimet e tyre ishin bazuar në rrezikun e trajtimit çnjerëzor ose degradues, i cili është absolutisht i ndaluar sipas Konventës Evropiane.

Gjykata, ndër të tjera, theksoi se gjykatat gjermane kishin dhënë arsye të hollësishme përse nuk kishin mundësi tjetër për t'i mbrojtur fëmijët. Në veçanti, prindërit ishin shprehur të bindur gjatë procedurës që ndëshkimi fizik ishte i pranueshëm dhe, edhe nëse do të ishin pajtuar që të ndërpritej ndëshkimi, nuk kishte asnjë mënyrë për të siguruar që nuk do të kryhej nga anëtarë të tjerë të komunitetit. Prandaj, gjykatat gjermane, në procedurat e drejta dhe të arsyeshme në të cilat rasti i secilit fëmijë ishte shqyrtuar në mënyrë individuale, kishte arritur një baraspeshë ndërmjet interesave të prindërve dhe interesave më të mira të fëmijëve.

*** Kohëzgjatja e tepërt e procedurave penale: Gjykata vëren se ekziston një mjet në Rumani, por që ka hyrë në fuqi vetëm pas parashtrimit të kërkesës (10/04/2018)**

Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, në aktgjykimin saj, në rastin **Brudan kundër Rumanisë** (kërkesa 75717/14), njëzëri, kishte konstatuar **se kishte pasur: shkelje të nenit 13 (E drejta për zgjidhje efektive)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe **shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (E drejta për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm)**.

Rasti kishte të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës penale të parashtruar kundër parashtruesit të kërkesës, i cili filloi më 23 mars 2000 dhe përfundoi më 18 qershor 2014. Gjykata konstatoi në veçanti se, nga aktgjykimi i saj në rastin Vlad dhe të tjerët kundër Rumanisë, zhvillimet në praktikën gjyqësore vendase nënkuptonin që procedura për përgjegjësi penale ishte bërë një mjet efektiv për t'u ankuar për tejzgjatjen e procedurës para gjykatave penale dhe civile në Rumani.

Megjithatë, gjykata vlerësoi se kur u paraqit kërkesa e tanishme ky mjet juridik ende nuk kishte fituar një shkallë të mjaftueshme të sigurisë juridike për të përbërë një mjet juridik efektiv i cili duhej të shterohej. Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk mund të ishte fajtor për mosshkrimin e tij. Sa i përket kohëzgjatjes së procedurës, Gjykata vuri në dukje se, edhe pse një pjesë e kohëzgjatjes së procedurës i ishte ngarkuar shtyrjeve të kërkuara nga parashtruesi dhe avokatët e saj, ato nuk mund të justifikonin kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave, të cilat kishin zgjatur për më shumë se 14 vjet.

Një gjatësi e tillë e procedurave nuk mund të konsiderohet e arsyeshme në kuptim të nenit 6 të Konventës.

*** Refuzimi i regjistrimit të Komunitetit Bektashi nga gjykatat maqedonase (12/04/2018)**

Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut në aktgjykimin e saj në rastin **Komuniteti Bektashi dhe të Tjerët kundër "ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë"** (nr. 48044/10, 75722/12 dhe 25176/13) konstatoi se kishte pasur: **shkelje të nenit 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit) në dritën e nenit 9 (Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe fesë)** - në lidhje me shoqatën e parashtruesit të kërkesës dhe ka dhënë 5.000 euro (dëmi jomaterial) dhe 2.000 euro (shpenzime) për shoqatën e parashtruesit.

Rasti kishte të bëjë me ankesën e Bashkësisë Bektashiane, një shoqatë fetare dhe dy nga anëtarët e saj, z. E. Brahimaj, një shtetas shqiptar dhe z. A. Sulejmani, një shtetas maqedonas, lidhur me vendimet e gjykatave vendase që refuzojnë ta njohin shoqatën si një organizatë fetare ose ta regjistrojnë atë përsëri. Kur në vitin 2007 hyri në fuqi ligji i ri, gjykatat vendase të IRJM-së kishin refuzuar të lejonin shoqatën të mbante statusin e saj si organizatë fetare dhe të pranonte kërkesën e saj të re për regjistrim. Shoqata e parashtruesve vepronte si një organizatë fetare e njohur zyrtarisht që nga viti 1993. Kur ligji i ri mbi statusin ligjor të kishave, bashkësive dhe grupeve fetare hyri në fuqi në vitin 2007, shoqata kërkoi që gjykata e regjistrimit të njohë statusin e saj të vazhdueshëm ligjor. Kërkesa e saj megjithatë u refuzua për shkaqe formale, përkatësisht nuk ishte regjistruar para vitit 1998, por vetëm në vitin 2000. Pas kësaj, bëri një kërkesë të re për regjistrim sipas legjislacionit të ri, por në vitin 2010 kjo kërkesë u refuzua, kryesisht për shkak se gjykatat konstatuan se emri i saj dhe burimet doktrimore ishin identike me ato të një organizate tjetër fetare tashmë të regjistruar dhe se kjo mund të krijonte konfuzion në mesin e besimtarëve.

*** Dëbimi i terroristit në Marok nuk ishte në kundërshtim me nenin 3 të Konventës (19/04/2018)**

Në aktgjykimin e saj në rastin **e A. S. kundër Francës** (kërkesa nr. 46240/15), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut njëzëri konstatoi se nuk ka pasur **shkelje të nenit 3 (Ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues)**, dhe me shumicë, se ka pasur **shkelje të nenit 34 (Kërkesat individuale)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me dëbimin në Marok të një shtetasi maroken, i cili ishte dënuar në Francë për konspiracion për të kryer akte terroriste dhe i cili më parë ishte privuar nga nacionaliteti i tij francez për të njëjtën arsye. Gjykata vuri në dukje në veçanti se Maroku kishte miratuar masa të përgjithshme për të parandaluar rreziqet e trajtimit në kundërshtim me nenin 3. Prandaj, kërkesa e tanishme dallonte nga rasti i M. A. kundër Francës. Për më tepër, pavarësisht



lirimit të tij, parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar ndonjë provë se kushtet e tij të paraburgimit kishin tejkaluar pragun e ashpërsisë së nevojshme për shkelje të nenit 3. Sa i përket nenit 34, Gjykata konstatoi se urdhri i dëbimit nuk i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës deri më 22 shtator 2015, ditën e lirimit të tij, më shumë se një muaj pasi ishte marrë vendimi dhe se ai ishte dërguar menjëherë në aeroport për dëbim në Marok. Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme për të kërkuar që Gjykata ta pezullonte vendimin, edhe pse autoritetet franceze e kishin marrë atë një kohë të gjatë më parë.

*** Kroacia ka dështuar të rregullojë statusin e qëndrimit të një emigranti pa shtetësi për shumë vite, duke shkelur të drejtën e tij për jetën private (26/04/2018)**

Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, në aktgjykimin e saj në rastin **Hoti kundër Kroacisë** (kërkesa nr. 63311/14), njëzëri konstatoi se ka pasur **shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me një emigrant në Kroaci i cili ishte ankuar se nuk kishte mundur ta rregullonte statusin e tij të qëndrimit që nga ardhja e tij në vend në vitin 1979. Prindërit e tij u larguan nga Shqipëria në vitin 1960 si refugjatë politikë dhe u vendosën në Kosovë; ai ka lindur atje disa vjet më vonë. Që nga ajo kohë, autoritetet shqiptare kanë thënë se ai nuk është shqiptar; sipas certifikatës së lindjes së tij, ai nuk ka shtetësi. Ai ka jetuar dhe punon me ndërprerje në Kroaci për pothuajse 40 vjet dhe nuk ka asnjë lidhje me ndonjë vend tjetër, pasi ai, ndërkohë, ka humbur kontaktin me të gjithë të afërmit e tij. Aktualisht i papunë për shkak se nuk ka status banimi, ai mbijeton duke kryer përkohësisht punë në ferma. Gjykata konstatoi veçanërisht se autoritetet kroate nuk kishin marrë parasysh kompleksitetin e situatës së z. Hoti në procedurat e ndryshme që ai kishte provuar të përdorte për të rregulluar statusin e tij të banimit. Prandaj, ai ishte, në moshën 55 vjeçare, në një situatë të pasigurt, me pak mundësi për të gjetur punë ose për të siguruar sigurim shëndetësor apo të drejta të pensionit. Në të vërtetë, në vend që ta ndihmojnë z. Hoti të kontaktojë autoritetet e një vendi tjetër për shkak të faktit se ai nuk ka shtetësi, autoritetet kroate kanë insistuar që ai është shtetas i Kosovës.

*** Jo të gjitha komentet kritike në artikujt e gazetave të Çeçenisë garantonin ndërhyrje të drejtave (09/05/2018)**

Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, në aktgjykimin e saj në rastin **Stomakhin kundër Rusisë** (kërkesa nr. 52273/07), njëzëri konstatoi se ka pasur **shkelje të nenit 10 (Liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me dënimin e z. Stomakhin me pesë vjet burgim për artikujt e gazetës që kishte shkruar për

konfliktin e armatosur në Çeçeni, për të cilat gjykatat e brendshme thoshin se kishin justifikuar terrorizmin dhe dhunën dhe nxitnin urrejtje. Gjykata gjeti se disa nga artikujt kishin shkuar përtej kufijve të kritikave të pranueshme dhe kishin qenë thirrje për dhunë dhe justifikim të terrorizmit. Megjithatë, deklaratat tjera kishin qenë brenda kufijve të pranueshëm të kritikës. Në përgjithësi, nuk kishte pasur nevojë të ngutshme sociale për të ndërhyrë në të drejtat e z. Stomakhin duke e dënuar atë për disa nga komentet e tij dhe ashpërsia e dënimit kishte shkelur të drejtat e tij. Gjykata u bëri thirrje qeverive të jenë të kujdesshme gjatë shqyrtimit se cila ishte gjuha e urrejtjes dhe çfarë ishte kritikë ndaj autoriteteve.

*** Gjykatat maqedonase nuk arritën të shqyrtonin nëse një urdhër dëbimi ishte lëshuar në baza të vërteta të sigurisë kombëtare (17/05/2018)**

Në aktgjykimin e saj në rastin **Latifi kundër “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”** (kërkesa nr. 19017/16), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, me gjashtë vota ndaj një, kishte konstatuar se kishte pasur **shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 7 (Garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me një ankesë të parashtruar nga një shtetas serb, i cili kishte jetuar në “ish-Republikën e Maqedonisë” nga moshja tetë vjeçare, se ajo ishte urdhëruar të largohej nga vendi, sepse paraqiste rrezik për sigurinë kombëtare dhe se ajo ishte nën kërcënim të menjëhershëm të dëbimit me forcë në çdo kohë. Gjykata konstatoi se gjykatat vendase nuk kishin arritur ta shqyrtonin pohimin e ekzekutivit se parashtruesja paraqiste rrezik për sigurinë kombëtare në mënyrë të kuptimplotë. Në veçanti, ato e kishin bazuar vendimin e tyre në një dokument të klasifikuar, i cili asnjëherë nuk ishte në dispozicion të tyre, dhe as të parashtrueses së kërkesës. Megjithëse Qeveria kishte dhënë një version të redaktuar të dokumentit në procedurat para Gjykatës, nuk ishte e mjaftueshme të vërtetohej se parashtruesja e kërkesës paraqite rrezik për sigurinë kombëtare. Asnjëherë nuk kishte pasur ndonjë procedurë penale kundër saj për ndonjë vepër penale.

*** Përgjimi nga një zyrtar policor i letrave të dorëzuara nga një avokat klientëve të tij, të cilët ishin nën shoqërimin e policisë, nuk ishte i justifikuar (24/05/2018)**

Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, në aktgjykimin e saj në rastin **Laurent kundër Francës** (kërkesa nr. 28798/13), njëzëri, kishte konstatuar se ka pasur **shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe korrespondencës)** së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me përgjimin nga ana e një zyrtari policor të letrave që një avokat u kishte dorëzuar



klientëve të tij, të cilët ishin nën përcjelljen e policisë, në hollin e ndërtesës së gjykatës. Gjykata konstatoi se përgjimi dhe hapja e korrespondencës së z. Laurent me klientët e tij, në cilësinë e tij si avokat, nuk i përgjigjej një nevojë urgjente sociale dhe nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike në kuptim të nenit 8 të Konventës. Gjykata ka specifikuar se një fletë e palosur e letrës në të cilën avokati kishte shkruar një porosi, përpara se t'u dorëzohej klientëve të tij, ishte korrespondencë e mbrojtur në kuptim të nenit 8. Gjykata theksoi se përmbajtja e dokumenteve të përgjuara nga zyrtari i policisë ishte i parëndësishëm nëse, pavarësisht nga qëllimi i saj, korrespondenca midis avokatëve dhe klientëve të tyre ka të bëjë me çështje të karakterit privat dhe konfidencial. Në rastin në fjalë, z. Laurent, në cilësinë e tij si avokat, kishte shkruar dhe dorëzuar letrat në fjalë klientëve para zyrtarit të lartë të shoqërimit, pa u përpjekur t'i fshihje veprimet e tij. Në mungesë të ndonjë dyshimi për një akt të paligjshëm, përgjimi i dokumenteve nuk mund të justifikohet.

*** Përgjimi masiv i komunikimit në Suedi plotëson standardet e Konventës (19/06/2018)**

Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, në aktgjykimin e Dhomës së saj, në rastin **Centrum för rättvisa kundër Suedisö** (kërkesa nr. 35252/08), njëzëri kishte konstatuar se nuk kishte pasur **shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me një ankesë të parashtruar nga një zyrë e avokatëve për interes publik ku pretendohet se legjislacioni që lejonte përgjimin masiv të sinjaleve elektronike në Suedi për qëllime të zbulimit të huaj kishte shkelur të drejtat e saj të privatësisë. Gjykata konsideroi se legjislacioni përkatës paraqet sistem të vëzhgimit

sekret që potencialisht kishte ndikuar në të gjithë shfrytëzuesit e telefonave celularë dhe të internetit, pa u njoftuar. Po ashtu, nuk kishte ndonjë mjet juridik të brendshëm që ofronte arsye të detajuara si përgjigje ndaj ankuesit, i cili dyshonte se komunikimi i tij ose i saj ishte përgjuar. Mbi këtë bazë, Gjykata e gjeti të arsyeshme të shqyrtojë legjislacionin në mënyrë abstrakte. Firma ligjore mund të pretendonte të ishte viktimë e një shkeljeje të Konventës, edhe pse nuk kishte iniciuar asnjë procedurë të brendshme ose pretendime konkrete se komunikimet e saj në të vërtetë ishin përgjuar. Vetëm ekzistenca e thjeshtë e ligjit përbënte vetvetiu një ndërhyrje në të drejtat e saj sipas nenit 8. Gjykata theksoi se megjithëse kishte disa fusha për përmirësim, në përgjithësi sistemi suedez i përgjimit masiv siguroi garanci adekuate dhe të mjaftueshme kundër arbitraritetit dhe rrezikut të abuzimit. Konkretisht, fushëveprimi i masave të inteligjencës së sinjaleve dhe trajtimi i të dhënave të përgjuara ishte përcaktuar qartë në ligj, leja për përgjim duhet të ishte me urdhër të gjykatës pas një ekzaminimi të detajuar, lejohej vetëm për komunikimet që kalonin kufirin suedez dhe jo brenda në Suedi, mund të ishte vetëm për një maksimum prej gjashtë muajsh, dhe për çdo përtëritje nevojitej shqyrtim. Përveç kësaj, ka pasur disa organe të pavarura, në veçanti inspektorat, të ngarkuara me mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e sistemit. Në fund, mungesa e njoftimit të masave të mbikëqyrjes ishte kompensuar me faktin se ekzistonte një numër i mekanizmave për ankesa që ishin në dispozicion, veçanërisht përmes inspektoratit, avokatit parlamentar dhe kancelarit të drejtësisë. Kur arriti në atë përfundim, Gjykata mori parasysh kompetencat diskrete të shtetit në mbrojtjen e sigurisë kombëtare, veçanërisht duke pasur parasysh kërcënimet aktuale të terrorizmit global dhe krimin të rëndë ndërkuftar.

(Për më shumë hollësi vizitoni faqen e internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: www.echr.coe.int)





Aktgjykim

KI 122/17

Parashtrues

Česká Exportní Banka A.S.

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit Ae. nr. 185/2017 të Gjykatës së Apelit, të 11 gushtit 2017, dhe Aktvendimit IV. EK. C. nr. 273/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 14 qershorit 2017

Parashtruesi i kërkesës ishte një shoqëri e huaj, “Česká Exportní Banka A.S.”, me seli në Republikën Çeke e cila kishte lidhur kontratë pune me një shoqëri vendore, “Compact Group Sh.P.K.”, me seli në Republikën e Kosovës. Palët kontraktuale ishin pajtuar që mosmarrëveshjet e tyre do t’i zgjidhnin përmes arbitrazhit dhe atë në Gjykatën e Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike të Republikës Çeke. Kjo e fundit, pas kërkesës së parashtruesit, nxori një Vendim të Arbitrazhit përmes së cilit e detyroi “Compact Group Sh.P.K.” që t’i paguaj parashtruesit të kërkesës shumën prej 1,364,527.00 € plus kamatëvonesë. Vendimi i Arbitrazhit u vërtetua nga gjykatat e rregullta dhe u shpall si vendim i ekzekutuëshëm në Republikën e Kosovës. Për më tepër, u vërtetua edhe Urdhëri Përmbarimor i lëshuar nga Përmbaruesi Privat që kërkonte përmbarimin e Vendimit të Arbitrazhit.

I.

Një ditë pasi që Vendimi i Arbitrazhit u vërtetua si vendim përfundimtar, i detyrueshëm dhe i zbatueshëm në Republikën e Kosovës, “Compact Group Sh.P.K.” mori vendim për shpërbërje vullnetare të shoqërisë së tyre. Nëpërmjet këtij vendimi, “Compact Group Sh.P.K.” deklaroi se nuk kishte asnjë detyrim të papaguar ndaj personave të tretë. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, anulimin e vendimit për shpërbërje vullnetare si të paligjshëm. Përveç kërkesave në padinë e tij kryesore, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore që të vendosë masë të sigurisë që kishte për qëllim ruajtjen e aseteve dhe të mjeteve të nevojshme për

ekzekutimin e Vendimit të Arbitrazhit. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për masë të sigurisë, gjykatat e rregullta morën gjithsej tetë vendime. U morën katër grupe të vendimeve në nivel të shkallës së parë dhe të apelit, përkatësisht katër vendime të Gjykatës Themelore dhe katër vendime të Gjykatës së Apelit. Në Gjykatën Kushtetuese u kontestua grupi i katërt i vendimeve Parashtruesi i kërkesës pretendoi se grupi i katërt i vendimeve i ka cenuar të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse ato vendime anuluan vendimet e mëhershme për të cilat parashtruesi i kërkesës konsideroi se ishin përfundimtare dhe detyruese, dhe si të tilla, *res judicata*.

Parashtruesi i kërkesës, përveç që kërkoi që vendimet e kontestuara të shpallen të pavlefshme, ai po ashtu kërkoi që vendimet që kishin arrit formën e prerë dhe detyruese, të shpallehin si vendime *res judicata*. Argumenti kryesor i parashtruesit të kërkesës ishte që Gjykata e Apelit kishte rihapur me vetë-iniciativë dhe përtej kërkesave të palëve ndërgjyqësore, çështje të cilat veçse i kishte konfirmuar vetë përmes një vendimi të saj të mëhershme.

II.

Gjykata Kushtetuese e shpalli kërkesën të pranueshme dhe gjeti shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sepse konsideroi që, Gjykata e Apelit nuk kishte respektuar parimin e sigurisë juridike, si dhe nuk kishte respektuar një vendim të formës së prerë. Më tutje, Gjykata po ashtu gjeti se Gjykata e Apelit kishte injoruar në tërësi të gjitha pretendimet e parashtruesit në lidhje me çështjet *res judicata* dhe nuk iu ishte përgjigjur argumenteve të parashtruesit lidhur me këtë çështje. Si rezultat i këtyre shkeljeve, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës është privuar nga përfitimi që sjell një vendim përfundimtar dhe i detyrueshëm i gjykatës.

Sa i përket procedurës në tërësi, Gjykata po ashtu shprehu shqetësimin e saj që parashtruesi është i detyruar të ndërmarrë këto procedura shtesë kundër shpërbërjes vullnetare të shoqërisë së të paditurit, në mënyrë që të realizojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar dhe të detyrueshëm lidhur me Vendimin e saj të Arbitrazhit.

Një pikë tjetër e rëndësishme e këtij Aktgjykimi është që, për herë të parë, Gjykata ka bërë interpretimin e zbatueshmërisë së nenit 31 të Kushtetutës (dhe nenit 6 KEDNJ) në procedurat paraprake. Bazuar në praktikën e GJEDNJ-së (*Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim, [DHM], 15 tetor 2009), Gjykata vendosi testin dy-hapësh në bazë të të cilit duhet të shqyrtohet zbatueshmëria e këtyre garancive, rast-për-rast. Përfundimisht, Gjykata e deklaroi kërkesën të pranueshme; konstatoi se ka pas shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; konstatoi se grupi i katërt i vendimeve (të kontestuara) janë të pavlefshme dhe nule; konstatoi se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ae. nr. 185/2017, i datës 16 dhjetor 2017] është përfundimtar dhe i detyrueshëm, dhe si i tillë *res judicata* lidhur me tri pika specifike, të cilat duhet të ekzekutohen.



Aktgjykim

KI 146/17, KI 147/17, KI 148/17, KI 149/17 dhe
KI 150/17

Parashtrues

Isni Thaçi, Zeqir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat
Demaku dhe Jahir Demaku

*Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.
KZZ. nr. 322/2016, të 19 korrikut 2017*

Në vitin 2013, kundër Isni Thaçit, Zeqir Demakut, Fadil Demakut, Nexhat Demakut dhe Jahir Demakut (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), dhe disa personave të tjerë, Prokurori i EULEX-it nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (Prokurori i PSRK-së), kishte ngritur aktakuzë me dyshimin e bazuar se ata gjatë vitit 1998, në bashkëkryerje, kishin kryer veprën penale të krimeve të luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës.

Në vitin 2015, Gjykata Themelore në Mitrovicë shpalli fajtor parashtruesit e kërkesës për kryerjen e veprave penale të cekura më lart. Parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore duke kontestuar, ndër të tjera, përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore, legjitimitetin e dëshmitarëve të ekzaminuar dhe mosmarrjen në pyetje të ekspertit të forenzikës. Gjykata e Apelit, i refuzoi ankesat e palëve dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke pretenduar, ndër të tjera, se trupi gjykues i Gjykatës Themelore ishte caktuar në kundërshtim me rregullat e aplikueshme për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në trupat gjykues.

Ata, po ashtu, përsëritën pretendimet e tyre për legjitimitetin e dëshmitarëve të ekzaminuar dhe mosthirrjen e ekspertit të forenzikës. Gjykata Supreme, me Aktgjykimin PML. KZZ. nr. 322/2016, të 19 korrikut 2017, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Ndërkaq, përkritazi me pretendimet e parashtruesve për shkelje të rregullave për caktimin e gjyqtarëve në trupin gjykues të Gjykatës Themelore, Gjykata Supreme arsyetoi se, bazuar në Udhëzimin për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në raste penale,

kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it ka liri të plotë për t'i caktuar gjyqtarët në kolegje. Për më tepër, Gjykata Supreme vlerësoi se edhe nëse ka pasur shkelje të rregullores së brendshme të EULEX-it (Udhëzimit), atëherë kjo do të ishte çështje e diskrecionit brenda autoriteteve administrative/disiplinore të EULEX-it.

I.

Në dhjetor të vitit 2017, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Parashtruesit e kërkesës pretenduan para Gjykatës Kushtetuese se, duke refuzuar kërkesën e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar, Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë drejtim, ndër të tjera, ata u ankuan se Gjykata Supreme nuk e adresoi në mënyrë të duhur çështjen e caktimit të gjyqtarëve në trupin gjykues të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se kjo ishte bërë në kundërshtim me rregullat për caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues. Në lidhje me plotësimin e kritereve të pranueshmërisë, Gjykata konstatoi se parashtruesit e kërkesës i kanë parashtruar kërkesat si palë të autorizuar, brenda afateve të përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj. Gjykata gjithashtu konsideroi se, kërkesa e parashtruesve ngre çështje serioze të fakteve dhe të ligjit, të cilat janë të një kompleksiteti të tillë sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi i meritave.

II.

Në trajtimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata Kushtetuese sqaroi se e drejta për një gjykim të drejtë përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar. Gjykata Kushtetuese më tej vlerësoi se, gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve në lidhje me caktimin e gjyqtarëve në trupin gjykues të Gjykatës Themelore, arsyetimi i Gjykatës Supreme kryesisht ishte i kufizuar në shkelje të mundshme të Kodit të Procedurës Penale, të cilat nuk i kishte arsyetuar mjaftueshëm dhe nuk kishte marrë parasysh dispozitat e tjera juridike për caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues. Gjykata Kushtetuese konstatoi se duke mos dhënë një vlerësim dhe justifikim të plotë se a janë respektuar garancitë procedurale për caktimin e gjyqtarëve në trupin gjykues të Gjykatës Themelore, Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtën e parashtruesve të kërkesës për një vendim të arsyetuar dhe rrjedhimisht të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Ndërkaq, për sa i përket pretendimeve për legjitimitetin të dëshmitarëve dhe mosthirrjen e ekspertit të forenzikës, Gjykata konstatoi se Gjykata Supreme ka dhënë arsyetim të hollësishëm. Gjykata Kushtetuese e shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Kushtetuese po ashtu sqaroi se, në rastin konkret ka shqyrtuar vetëm aspekte të respektimit të procedurës kushtetuese dhe të drejtave të njeriut pa paragjykuar fajësinë ose pafajësinë e parashtruesve të kërkesës.



Aktgjykim

KO 12/18

Parashtrues

Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017

Më 20 dhjetor 2017, Qeveria e Kosovës nxori Vendimin nr. 04/20 për ndryshimin dhe rritjen e pagës bruto të funksionarëve shtetërorë dhe vartësve të tyre. Ky ndryshim i pagës *ex lege* ishte i vlefshëm edhe për gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha instancave në Republikën e Kosovës. Dy ditë më pas, më 22 dhjetor 2017, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Më 29 janar 2018, 31 deputetë të Kuvendit të Kosovës parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë, nr. 04/20, duke pretenduar se vendimi i kontestuar nuk ishte në pajtueshmëri me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 65 [Kompetencat e Kuvendit], 92 [Parimet e Përgjithshme] dhe 93 [Kompetencat e Qeverisë], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, pretenduan se ndryshimi dhe rritja e pagave është kompetencë ekskluzive e Kuvendit, se ndryshimi dhe rritja e pagave për funksionarët shtetërorë dhe për sektorin e drejtësisë duhet të bëhet me ligj të miratuar nga Kuvendi, se rritja e pagave afekton direkt buxhetin e Kosovës dhe se ndryshimi i pagave përbën konflikt interesi.

Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën të pranueshme për shqyrtim pasi konstatoi se çështjet e ngritura në kërkesë janë të kompleksitetit të tillë, sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi i meritave, dhe se kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës së Gjykatës.

I.

Pas shqyrtimit të pretendimeve dhe të argumenteve të

parashtruesve të kërkesës, Gjykata Kushtetuese theksoi se: (i) nuk është dëshmuar se vendimi për rritjen e pagave përbën çështje të nivelit kushtetues; (ii) bazuar në argumentet e paraqitura, nuk rezultoi se Kuvendi i është cenuar apo pamundësuar ushtrimi i kompetencave të tij kushtetuese për miratimin dhe zbatimin e buxhetit shtetëror; (iii) për sa i përket konfliktit të interesit, se nuk është brenda funksionit të Gjykatës që të vlerësojë pretendimet për shpërputhjen e vendimit të kontestuar me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, sepse ajo çështje bie nën juridiksionin e organeve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë; dhe (iv) për sa i përket shkeljeve të neneve 3 [Barazia para Ligjit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës, parashtruesit nuk kanë paraqitur fakte bindëse se pagat e parapara në Vendimin e kontestuar trajtojnë ndryshe pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Gjykata, më tej shtoi se nuk është brenda fushëveprimit të saj që të vlerësojë apo të zëvendësojë politikat publike të përcaktuara nga organi legjislativ apo ekzekutiv. Parimi i ndarjes së pushteteve detyron Gjykatën Kushtetuese që të respektojë përcaktimin e politikave nga organet gjegjëse kushtetuese.

Vendimet themelore të politikëbërjes për qeverisjen e vendit duhet të merren nga organet kushtetuese me legjitimitet demokratik, përkatësisht nga Kuvendi dhe Qeveria. Ato organe – për shkak të natyrës së tyre dhe të legjitimitetit demokratik – janë në pozitë më të mirë se sa Gjykata Kushtetuese për të përcaktuar dhe për të avancuar politikat buxhetore, ekonomike dhe sociale të vendit.

II.

Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konsideroi se parashtruesit e kërkesës nuk kishin paraqitur prova bindëse për të mbështetur pretendimet e tyre se Vendimi i kontestuar i Qeverisë ka prodhuar efekte kushtetuese, në kuptim të cenimit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, apo shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese, ashtu siç pretendonin parashtruesit e kërkesës.

Gjykata gjithashtu vuri në dukje se aktet nënligjore të Qeverisë duhet të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe me ligjet. Për më tepër, Gjykata theksoi se, në përputhje me natyrën ekzekutive të kompetencave të saj kushtetuese, Qeveria është e detyruar të implementojë buxhetin shtetëror, të miratuar nga Kuvendi. Andaj, është obligim i Qeverisë që zbatimin e vendimit të kontestuar ta mbështesë në ndarjet buxhetore të përcaktuara në Buxhetin e vitit 2018 dhe në ligjet përkatëse.

Në fund, Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113. 2 (1) dhe 116. 2 të Kushtetutës, të neneve 27 (1), 29 dhe 30 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullave 29, 54, 55 dhe 56 (1) të Rregullores së punës, konstatoi se Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 20/14, i 20 dhjetorit 2017, nuk është në kundërshtim me nenet e pretenduara të Kushtetutës.

INFORMATA PËR GJYKATËN

Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen “Pejton”. Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuar në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është rasti me ndërtimin e sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimin e Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011.

Objekti i Gjykatës ka gjithsej 784 m² hapësirë të shfrytëzueshme për punë, që shfrytëzohet nga 65 punonjës.



ADRESA

Rruga: “Perandori Justinian”, nr. 44, 10000, Prishtinë

Tel: +381 (0)38 60 61 62

Mob: +377 (0)45 200 595; +377 (0)45 200 576

Fax: +381 (0)38 60 61 70

E-mail: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org

Ueb: www.gjk-ks.org